

## KALLZIM PENAL

**KALLZUES:** Partia Demokratike Dega Vlore, Perfaqesuar nga Z. Genc Deromemaj .

**ME OBJEKT:** Kallzim i veprës penale të parashikuar në nenet 248 "Shpërdorimi i detyrës" dhe 258 "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike" të Kodit Penal.

**KUNDER:** [REDACTED]

**BAZA LIGJORE:** Nenet 280 dhe 283 të K.Pr.Penale, si dhe nenet 248 dhe 258 të Kodit Penal.

**DREJTUAR:** Struktura se Posacme kunder Korrupsionit dhe Krimet te Organizuar  
SPAK

TIRANË

Bazuar në nenet 280 dhe 283 të Kodit të Procedurës Penale parashtrijmë këtë kallzim penal për veprën penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallzimi, provat me të cilat vërtetohen këto fakte, si dhe dispozitat ligjore penale të cenuara.

### **I. RRETHANAT E FAKTEVE**

1.1. Autoriteti Kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit rezultojnë se ka hapur procedurën e prokurimit për " Rikualifikimin urban pranë qendres së qytetit Vlore, Zona A drejtimi i kullës së Sahatit dhe Sheshi I Flamurit me nr ref – 74310-10-07-2020. Fondi Limit për këtë prokurim referuar dokumenteve standarte të prokurimit është 919.315102.50 leke pa TVSh. Lloji i procedurës së prokurimit të shpallur nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit është " Procedure e hapur ".

Referuar dokumentacionit të prokurimit rezultojnë se për këtë prokurim kanë shfaqur interes dhe kanë marrë pjesë në këtë procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara

- a. [REDACTED] me vlerë të ofruar 698.150.210.94 leke pa TVSH;
- b. [REDACTED] me vlerë të ofruar 76030142.65 leke pa TVSH;
- c. [REDACTED] dhe [REDACTED] k. me vlerë të ofruar 542 052437.49 leke pa TVSH;
- d. [REDACTED] me vlerë të ofruar 688 967 812.31 leke pa TVSH;
- e. [REDACTED] me vlerë të ofruar 725 201 821 leke pa TVSH;
- f. [REDACTED] me vlerë të ofruar 638 648.099 leke pa TVSH;
- g. [REDACTED] nuk ka paraqitur oferte ekonomike .

